# KIRFN Interpretimi 7
## *Zbatimi i Metodës së Riparaqitjes sipas SNK 29 Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacioniste*

## Referencat

- SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*
- SNK 29 *Raportimi financiar në ekonomitë hiperinflacioniste*

## Konteksti

1 Ky interpretim jep udhëzime për mënyrën si duhet të zbatohen kërkesat e SNK 29 në një periudhë raportuese në të cilën një njësi ekonomike identifikon[1] ekzistencën e hiperinflacionit në ekonominë e monedhës së saj funksionale, kur kjo ekonomi nuk ishte hiperinflacioniste ne periudhën e mëparshme, dhe njësia ekonomike si pasojë riparaqet pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNK 29.

## Çështjet

2 Pyetjet që adresohen në këtë interpretim janë:

(a) në ç`mënyrë duhet të interpretohet kërkesa '…shprehur ne termat e njësisë matëse aktuale në fund të periudhës së raportimit" në paragrafin 8 të SNK 29, kur një njësi ekonomike aplikon Standardin?

(b) si duhet të përcaktojë një njësi ekonomike zërat e tatimeve të shtyra në çelje në pasqyrat e saj financiare të riparaqitura?

## Konsensusi

3 Në periudhën raportuese në të cilën një njësi ekonomike identifikon ekzistencën e hiperinflacionit në ekonominë e monedhës së saj funksionale, duke mos qenë hiperinflacioniste në periudhën e mëparshme, ajo do të zbatojë kërkesat e SNK 29 sikur ekonomia të kishte qenë gjithnjë hiperinflacioniste. Prandaj, në lidhje me zërat jo-monetarë të matur me kostot historike, pasqyra e pozicionit financiar të çeljes së njësisë ekonomike në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur në pasqyrat financiare do të riparaqitet, për të pasqyruar efektin e inflacionit nga data e blerjes së aktiveve dhe data kur detyrimet janë shkaktuar apo pranuar, deri në fund të periudhës raportuese. Për treguesit jomonetarë të mbajtur në pasqyrën e pozicionit financiar të çeljes me shumat aktuale në datat që ndryshojnë nga data e blerjes dhe ndodhjes, kjo riparaqitje do të tregojë më mirë efektin e inflacionit që nga datat kur këto shuma të mbartura u përcaktuan deri në fund të periudhës raportuese.

4 Në fund të periudhës së raportimit, zërat e tatimeve të shtyra maten dhe njihen në përputhje me SNK 12. Megjithatë, shifrat e tatimeve të shtyra në pasqyrën e pozicionit financiar te çeljes për periudhën raportuese do të përcaktohen si më poshtë:

(a) njësia ekonomike rimat zërat e tatimeve të shtyra në përputhje me SNK 12 pasi ajo ka riparaqitur vlerat kontabël (neto) nominale të zërave të saj jo-monetarë në datën e çeljes së pasqyrës së pozicionit financiar të periudhës raportuese duke zbatuar njësinë matëse në këtë datë.

(b) zërat e tatimeve të shtyra të ri matura në pajtim me (a) janë riparaqitur për ndryshimin në njësinë matëse nga data e çeljes së pasqyrës së pozicionit financiar të periudhës raportuese deri në fund të periudhës raportuese.

Njësia ekonomike zbaton metodën (a) dhe (b) në riparaqitjen e zërave të tatimeve të shtyra në pasqyrën e pozicionit financiar te çeljes të çdo periudhe krahasuese të paraqitur në pasqyrat financiare të ri paraqitura për periudhën raportuese në të cilën njësia zbaton SNK 29.

[1] Identifikimi i hiperinflacionit bazohet në gjykimin që u bën njësia ekonomike kritereve në paragrafin 3 të SNK 29.

5 Pasi një njësi ekonomike ka riparaqitur pasqyrat e saj financiare, të gjitha shifrat korresponduese në pasqyrat financiare për një periudhë raportuese të mëpasshme, përfshirë zërat e tatimeve të shtyra, ri pasqyrohen duke zbatuar ndryshimin në njësinë matëse për këtë periudhë raportuese pasuese, vetëm për pasqyrat financiare të ri paraqitura për periudhën raportuese paraardhëse.

## Data e hyrjes në fuqi

6 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë Interpretim për periudhat vjetore që fillojnë me datën 1 mars 2006 ose pas kësaj date. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë Interpretim për një periudhë që fillon para datës 1 mars 2006, ajo do të do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

 © Fondacioni i SNRF-ve